

Arif (Demush) Gjocaj

(10.05.1965, shqiptar nga fshati Gjocaj/Đocaj, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Shkëlzen (Rexhë) Gacaferri

(22.06.1971, shqiptar nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Arifi aderoi në radhët e UÇK-së më 10.04.1998, ndërkaq Shkëlzeni më 10.06.1998. Në datën **28.07.1998**, gjatë betejës me pjesëtarë të forcave serbe në **Gjocaj/Đocaj**, Arifi dhe Shkëlzeni kanë rënë në vendin e quajtur *Zharet e Gjocajeve/Đocajeve žare*.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Mirsad (Zenel) Idrizaj

(7.07.1976, shqiptar nga Lubozhda/Ljubozhde, komuna e Istogut/Istok, punëtor krahu, pjesëtar i UÇK-së)

Mirsadi u inkuadrua në UÇK më 12.07.1998. Së pari ishte caktuar me detyrë në fshatin Glllogjan/Glođane, e më pas në Junik dhe Jasiq/Jasić. Mirsadin e kanë varrosur në vendin ku ai gjeti vdekjen. Pas përfundimit të luftës, mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në varrezat e Lubozhdës/Ljubozhda.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; SHF DUÇK, *Feniksët...* 9, 161-162.

Zekë (Sali) Tofaj

(16.10.1924, shqiptar nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, nëntë fëmijë)

Zeka i moshuar jetonte në bashkësi me djemtë Qazimin dhe Skënderin dhe familjet e tyre në lagjen *Kallavaj* në **Junik**. Ishte i palëvizshëm. Gjatë muajit korrik të vitit 1998, në shtëpinë e tij gjendeshin edhe refugjatë nga fshatrat përreth. Forcat serbe, të cilat ishin të stacionuara në fshatin Batushë/Batuša, erdhën në lagjen e tij më **28.07.1998**. E gjithë familja e Zekës u zhvendos në lagjen *Gacaferi* përpos Zekës, i cili mbeti në shtëpi. Po atë ditë, nga ora 16:00, djemtë e tij dhe disa të

afërm u kthyen në mëhallë për ta tërhequr Zekën dhe një plak tjetër [Avdulla Tofaj], por pjesëtarë të forcave serbe hapën zjarr drejt tyre nga tanket, të cilët ishin të pozicionuar afro 150 metra nga shtëpia e Zekës. Me këtë rast u qëllua dhe u plagos një i afërm i familjes me emrin Asllan, gjë që e detyroi grupin që të hiqte dorë nga tentimi për t'i tërhequr këta dy pleq. Në të njëjtën mbrëmje, ata u detyruan të tërhiqeshin nga fshati. Për shkak të situatës së rëndë të sigurisë, nuk ishin më në gjendje të ktheheshin në shtëpitë e veta deri në muajin nëntor të vitit 1999. Fati i Zekës nuk është zbardhur ende. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është evidentuar në lëndën me numrin rendor BLG-803239-01.

Burimet: deklaratat S.T, FDH-19233; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Zejnije (Osmon) Krasniqi

(12.04.1963, shqiptare nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, infermiere)

Gjatë kohës së luftës, Zejnija u ndihmonte pjesëtarëve të plagosur të UÇK-së, duke u përkujdesur për shërimin e tyre. Jetonte me të ëmën. Kur të gjithë banorët e lagjes *Çok* të **Junikut/Junik**, në muajin korrik të vitit 1998, u larguan nga fshati përpos pjesëtarëve të UÇK-së, ajo vendosi të qëndronte në shtëpi me nënën Xufen. Gjatë granatimeve të forcave serbe më **29.07.1998**, një predhë e ka qëlluar shtëpinë e Zejnijes. Me këtë rast, ajo u plagos rëndë, ndërsa e ëma lehtë. Ciflat e predhës e kanë qëlluar Zejnijen në stomak, gjoks dhe gati ia kishin këputur këmbën e majtë. Një i afërm, pjesëtar i UÇK-së dhe disa ushtarë të tjerë i ofruan ndihmën e parë. Pastaj, e çuan në spitalin që gjendej në lagjen *Gacaferi*. Ngase atje nuk kishte kushte për të ndërmarr intervenime kirurgjikale, ajo dha shpirt pas tri orësh. Zejnijen e varrosën po atë ditë, buzë lumit Ereniku. Në muajin gusht të vitit 1999, mbetjet e saj mortore u rivarrosen në varrezat pranë xhamisë në Junik.

Burimi: deklaratat R.K, FDH-19237.
